



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 shtator 2013
Nr. ref.:AGJ469/13

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. K095/13

Parashtrues

Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Visar Ymeri, Albin Kurti, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Albana Gashi, Florin Krasniqi, Emin Gërbeshi, Albana Fetoshi dhe Agim Kuleta, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës e kanë

autorizuar z. Visar Ymeri për t'i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Ligjin, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ratifikim), që ishte miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), më 27 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së Ligjit për Ratifikim, që u miratua nga Kuvendi, me Vendimin Nr. 04-V-638, të 27 qershorit 2013.

Baza juridike

4. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 42 dhe neni 43 i Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 4 korrik 2013, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë.
6. Më 4 korrik 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KO95/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO95/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtarë).
7. Më 5 korrik 2013, parashtruesit e kërkesës paraqitën një korrigjim të kërkesës, në pajtim me rregullin 31.1 Rregullores së punës, me të cilin parashihet: *“Në çfarëdo kohe para se Gjyqtari raportues të ketë paraqitur raportin e tij/saj, pala e cila e ka parashtruar kërkesën ose Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare, mund të dorëzojë në Sekretariat përmirësimin e gabimeve teknike ose numerike në materialin e parashtruar”*. Parashtruesit e kërkesës e korrigjuan faqen 17 të kërkesës, nën numrin romak VI (Pasqyra e zgjidhjes së kërkuar), duke fshirë nenin 113.2, rregullin 54 dhe rregullin 55, të Rregullores së punës. Parashtruesit e kërkesës, po ashtu, dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë: autorizimin, nënshkrimet dhe fotokopjet e letërnjoftimeve të deputetëve që ishin pjesë e kërkesës.
8. Më 9 korrik 2013, Gjykata e njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) për parashtrimin e

kërkesës në Gjykatë nga parashtruesit dhe kërkoi nga të njëjtit që të dorëzonin komentet e tyre, së bashku me dokumentet për të cilat konsiderojnë se janë të nevojshme përkitazi me kërkesën e parashtruar.

9. Më 9 korrik 2013, u njoftua Presidentja e Republikës së Kosovës për kërkesën e parashtruar në Gjykatë nga parashtruesit.
10. Më 18 korrik 2013, Gjykata mori këto dokumente nga Kryetari i Kuvendit:
 - a. Raportin final të Komisionit për Legjislacion, të 17 qershorit 2013, përkitazi me Projektligjin për Ratifikim;
 - b. Transkriptin e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 27 qershor 2013 dhe më 4 korrik 2013;
 - c. Procesverbalin e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 27 qershor 2013 dhe më 4 korrik 2013;
 - d. Listën e deputetëve që kanë votuar në formë elektronike;
 - e. Vendimin e Kuvendit, të 27 qershorit 2013, për miratimin e Ligjit, Nr. 04/L-199, për Ratifikim (Vendimi Nr. 04-V-638);
 - f. Vendimin (Nr. 01/132) e Qeverisë, me të cilin *“Aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje”*;
 - g. Ligji për Ratifikim;
 - h. Marrëveshjen e parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e parë ndërkombëtare); dhe
 - i. Planin e zbatimit të Marrëveshjes (në tekstin e mëtejme: Plani i zbatimit).
11. Gjykata nuk ka marrë asnjë koment, as nga Kuvendi e as nga Qeveria.
12. Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e përgatitur nga gjyqtarja Snezhana Botusharova, Gjyqtare raportuese, dhe i paraqiti rekomandim Gjykatës në përbërje të plotë.
13. Më 2 shtator 2013, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 18 tetor 2012, Kuvendi, me propozim të grupeve parlamentare: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK),

Koalicioni për Kosovën e Re (KKR), Partia e Pavarur Liberale (SLS) dhe Grupi 6+, miratoi Rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Nr. 04-R-08 (e publikuar në ueb-faqen e Kuvendit). Sipas kësaj rezolute:

- a. *“Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet procesin e zgjidhjes së problemeve midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, në interes të normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin”;*
- b. *“[...] Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm - rendin unik kushtetues të Kosovës”;*
- c. *“[...] Kuvendi i Republikës së Kosovës e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës që të udhëheqë këtë proces, me pjesëmarrje të komisioneve të nevojshme të Kuvendit të Kosovës [...]”;*
- d. *“[...] Marrëveshjet e procesit të normalizimit të marrëdhënieve midis dy shteteve do të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës”.*

15. Më 22 prill 2013, gjatë një seance të jashtëzakonshme të kërkuar nga Kryeministri, Kuvendi miratoi Rezolutën për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Nr. 04-R-10 (e publikuar në ueb-faqen e Kuvendit). Sipas kësaj rezolute:

- a. *“Kuvendi i Kosovës shpreh përkrahje dhe jep pëlqimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë [...]”;*
- b. *“[...] Kuvendi i Kosovës mbështet zotimet e përmbajtura në këtë marrëveshje [...]”.*

16. Më 28 maj 2013, Qeveria miratoi Vendimin Nr. 01/132, ku thuhet: *“Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje”.* Përveç kësaj, në pajtim me këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit e procedoi Projektligjin për shqyrtim dhe për miratim në Kuvend.

17. Në të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit ua dërgoi të gjithë deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Ratifikim. Përveç kësaj, Komisioni për Legjislacion u ngarkua për të shqyrtuar këtë ligj dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

18. Më 24 qershor 2013, Komisioni për Legjislacion ua dërgoi deputetëve të Kuvendit rekomandimin që Projektligji për Ratifikim duhet të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi. Ky komision propozoi tri amendamente në këtë ligj:

- a. Amendamenti 1: *“Në titullin e projektligjit hiqen fjalët ‘DHE TË PLANIT TË ZBATIMIT PËR KËTË MARRËVESHJE’”;*

- b. Amendamenti 2: Neni 1 i Projektligjit riformulohet si vijon: “*Neni 1 – Qëllimi, Ky ligj ratifikon Marrëveshjen e parë ndërkombëtare që rregullon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe nga Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Vendimi Nr. 011126, dhe nga Kuvendi Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10*”; dhe
- c. Amendamenti 3: Neni 2 i Projektligjit riformulohet si vijon: “*Neni 2 - Fushëveprimi, Fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe është pjesë përbërëse e këtij ligji. Ky ligj do të zbatohet nga Republika e Kosovës, me ndihmën e Bashkimit Evropian (BE), Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior në Kosovë (KFOR), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)*”.
19. Më 27 qershor 2013, Kuvendi mbajti seancë plenare, ku u votua dhe u miratua Ligji, Nr. 04/L-199, për Ratifikim. Amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion nuk u aprovuan. Në bazë të listës së votimit elektronik dhe në bazë të transkriptit të Kuvendit, nga deputetët e pranishëm 84 votuan për, 3 deputetë ishin kundër dhe 1 deputet abstenoj.
20. Në të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit, në mbështetje të nenit 65.1 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, që parasheh se “*Kuvendi i Republikës së Kosovës; (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme*”; në mbështetje të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës; dhe në mbështetje të rregullit 60 [Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare] të Rregullores së punës të Kuvendit, nxori Vendimin Nr. 04-V-638, sipas të cilit “*Miratohet Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Nr. 04/L-199*”. Përveç kësaj, në bazë të pikës 2 të këtij vendimi, “*Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës*”.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës

Sa i përket aspektit procedural të kërkesës

21. Parashtruesit parashtruan kërkesë në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, pasi konsiderojnë se Ligji për ratifikimin dhe Marrëveshja e parë ndërkombëtare e vënë si aneks i Ligjit, nuk janë miratuar në pajtim me procedurat legjislative, si në kuadër të Qeverisë ashtu edhe me rastin e shqyrtimit nga Kuvendi. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë bërë këto tri shkelje procedurale:
- a) Procedura e ndjekur nga Qeveria për miratimin e Projektligjit për Ratifikim ka shkelur nenin 5 dhe nenin 11.1 të Ligjit për marrëveshjet

- ndërkombëtare, pasi Projektligji nuk u është dorëzuar agjencive dhe ministrive relevante për shqyrtim;
- b) Procedura e ndjekur nga Qeveria për paraqitjen e Projektligjit në Kuvend përbën shkelje të nenit 54.1.b dhe të nenit 60.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, pasi Ligji nuk i është bashkëngjitur, *inter alia*, Deklarata për implikimet buxhetore; dhe
- c) Procedura e ndjekur për miratimin e Projektligjit në Kuvend përbën shkelje të nenit 60.3 dhe të nenit 54.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, si dhe rregullat specifike që përmban Shtojca 2 e Rregullores së punës, pasi Projektligji asnjëherë nuk iu dorëzua komisioneve të ndryshme të Kuvendit për shqyrtim.
22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur nga Qeveria për miratimin e Projektligjit përbën shkelje të nenit 5 dhe të nenit 11.1 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare (Ligji nr. 04/L-52). Parashtruesit e kërkesës, së pari, shpjegojnë konceptin e rezervës në të drejtën ndërkombëtare dhe, sa i përket kësaj, i referohen nenit 3.1.9 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, ku nocioni rezervë shpjegohet kështu: *“Rezervë - deklaratë e njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një marrëveshjeje me anën e së cilës synon të përjashtojë ose të modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara”*. Duke marrë parasysh se legjislacioni i Kosovës që është në fuqi parasheh instrumentin e rezervës, ata konsiderojnë se çdo marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe ndonjë subjekti ndërkombëtar duhet të marrë parasysh nenin 11 të këtij ligji, sipas të cilit, në çdo rast, kur kemi të bëjmë me marrëveshje ndërkombëtare që kanë implikime në legjislacionin e brendshëm, institucioni përgjegjës duhet të përgatisë një dokument i cili sqaron implikimet e tilla.
23. Parashtruesit e kërkesës më tej i referohen nenit 11.1 të Ligjit, ku thuhet si në vijim: *“Në qoftë se ekzistojnë rezerva dhe/ose ka deklaratë rreth marrëveshjes ndërkombëtare, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i raporton këto te ministritë dhe te agjencitë qeveritare relevante gjatë procedurës së shqyrtimit në bazë të nenit 5 të këtij ligji”*, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet: *“Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse përfshin tekstin e rezervave dhe/ose deklaratave në projektligjin e Republikës së Kosovës rreth ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare ose projektin e dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe bën përkthimin e këtyre rezervave dhe/ose deklaratave në gjuhën e huaj përkatëse”*.
24. Sipas këndvështrimit të parashtruesve, në bazë të nenit 5 të Ligjit, teksti i Projektmarrëveshjes së parë ndërkombëtare është dashur t’i dërgohet agjencive apo ministrive të fushave përkatëse për shqyrtim.
25. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se procedura e ndjekur nga Qeveria për paraqitjen e projektligjit në Kuvend përbën shkelje të nenit 54.1.b dhe të nenit 60.2 të Rregullores së punës të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës po ashtu i referohen nenit 54 [Kushtet e parashtrimin të një projektligji], paragrafi 1, të Rregullores së punës të Kuvendit, sipas të cilit projektligji i cili paraqitet në Kuvend duhet të përmbajë:

- a. Shkresën shpjeguese për objektivat që synon t'i realizojë ligji, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe arsyetimin e dispozitave të ligjit;
 - b. Deklaratën për ndikimin buxhetor në vitin e parë dhe në vitet e mëpastajme;
 - c. Deklaratën për përafrimin dhe për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me tabelën krahasuese me aktet të cilave u referohet.
26. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se Qeveria e ka proceduar Projektligjin për Ratifikim, që përmban vetëm shkresën shpjeguese, por jo edhe atë që është e rëndësishme – Deklaratën për ndikimin buxhetor, siç parashihet me nenin 54.1.b, dhe Deklaratën financiare, siç kërkohet me nenin 60.2 të Rregullores së punës të Kuvendit. Sipas mendimit të tyre, pasi pika 7 dhe pika 10 të Marrëveshjes parashohin integrimin e strukturave paralele gjyqësore dhe të sigurisë, nuk ka dyshim se Marrëveshja ka implikime buxhetore.
27. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se, me procedurën e ndjekur për miratimin e Projektligjit për Ratifikim në Kuvend, janë shkelur neni 60.3 dhe neni 54.1 të Rregullores së punës të Kuvendit. Ata citojnë nenin 60.3 të Rregullores së punës të Kuvendit, që parasheh: *“Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi”*. Kjo nënkupton që, pasi është procedurë e veçantë dhe përjashton shqyrtimin e dytë të projektligjit, në përputhje me këtë, procedura në komisionet e përhershme dhe funksionale duhet të zhvillohet para votimit në seancë plenare të Kuvendit, ku duhet të miratohet Projektligji për Ratifikim.
28. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Projektligji për Ratifikim nuk ka kaluar nëpër procedurën e shqyrtimit në Komisionin e përhershëm për Buxhet dhe Financa dhe në Komisionin e përhershëm për Punë të Jashtme dhe, në bazë të nenit 54.1 të Rregullores, i njëjti është dashur të shqyrtohet edhe nga Komisioni funksional, si komision raportues, si dhe nga komisionet: për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Buxhet dhe Financa, për Integrim Evropian, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione kryesore.
29. Ata, më tej, parashtrojnë se Komisioni për Legjislacion i Kuvendit, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Ratifikim, asnjëherë nuk e ka shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e asaj që tani është ligj i ratifikuar. Për më tepër, duke marrë parasysh përgjegjësitë e tij të përcaktuara në Shtojcën 2, pika 3, të Rregullores së punës të Kuvendit, ku thuhet: *“Analizon dhe vlerëson përshtatshmërinë e akteve të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës me Kushtetutën”, dhe “Shqyrton projektligjet në aspektin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë”*, Komisioni ka refuzuar një shqyrtim të tillë, me gjithë faktin se kjo çështje përbën pjesë të përgjegjësive të tij kryesore.
30. Parashtruesit e kërkesës shtojnë se në Shtojcën 2, pika 5 [Komisioni për Punë të Jashtme], të Rregullores së punës të Kuvendit, dy pika, në veçanti, definojnë konkretisht detyrat e këtij komisioni: *“Ratifikimin në bllok ose ndaras të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë”*, dhe

“Përcjelljen e negociatave të udhëhequra nga Qeveria për bashkëpjesëmarrje të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre”.

31. Sa i përket pikës së parë, ata mëtojnë se kjo pikë thekson ratifikimin e marrëveshjeve e të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë dhe, rrjedhimisht, aludon në shqyrtim nga Komisioni para se ndonjë organ shtetëror të ndër marrë iniciativë për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare. Qëllimi i paragrafit të parë është që gjithmonë të merret mendimi i Komisionit për Punë të Jashtme, para lidhjes së një marrëveshje nga ana e Kosovës.
32. Sa i përket pikës së dytë, të përmendur më lart, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Komisioni për Punë të Jashtme ka të drejtë të iniciojë debate në Kuvend për procedurën e pararatifikimit që, sipas tyre, është e ngjashme me sistemin anglosakson të kontrollit dhe të balancimit, ku pushtetet legjislative dhe ekzekutive në procesin e vendimmarrjes balancohen ndaj veprimeve të shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ata theksojnë se Rregullorja e punës e Kuvendit është rregullore me klasifikim të veçantë juridik në hierarkinë juridike, pasi ajo është burim formal i Kushtetutës dhe, si e tillë, është e obligueshme dhe ka epërsi ndaj ligjit.
33. Parashtruesit e kërkesës konkludojnë se Qeveria e ka injoruar Komisionin për Punë të Jashtme, në kundërshtim me Rregulloren e punës të Kuvendit.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të kërkesës:

34. Parashtruesit parashtruan kërkesë në Gjykatë gjithashtu për vlerësim të kushtetutshmërisë së vetë Ligjit të kontestuar për Ratifikim, për shkak se Marrëveshja e parë ndërkombëtare e vënë si aneks i Ligjit për Ratifikim përmban 15 pika përkitazi me themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave në veri, që pretendohet se shkelin Kushtetutën, si në vijim:
 - a. Pika 1 deri në pikën 6 cenon në nenin 1.1 të Kushtetutës së Kosovës, ngase cenon pandashmërinë dhe unitetin e shtetit të Kosovës;
 - b. Pika 1 e Marrëveshjes është në kundërshtim me nenin 3.1 të Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike. Po ashtu, ajo është në kundërshtim me parimet e shprehura të nenit 123.3 të Kushtetutës për parimet e vetëqeverisjes lokale;
 - c. Pika 3 cenon në nenin 1.1 të Kushtetutës ku Republika e Kosovës cilësohet shtet unik;
 - d. Pika 4 është në kundërshtim me parimet kushtetuese të theksuara në nenin 123 dhe në nenin 124 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe tejkalon parimet e nenit 2 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (në tekstin e mëtejshëm: KEVQL);
 - e. Pika 6 cenon në nenin 1.1 të Kushtetutës ku Republika e Kosovës cilësohet shtet unik;
 - f. Pika 7 është në kundërshtim me parimet e përgjithshme kushtetuese që lidhen me sektorin e sigurisë, siç përcaktohet me nenin 125.2 të Kushtetutës;

- g. Pika 9 është në kundërshtim me nenin 3.1 (Cilësia Shumetnike e Republikës së Kosovës) dhe me nenin 125.2 e me nenin 24.2 të Kushtetutës;
- h. Pika 10 është në kundërshtim me nenin 102.2 dhe me nenin 24.1 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, që lidhen me nenin 13 dhe me nenin 14 të KEDNJ-së;
- i. Pika 11 është në kundërshtim me nenin 139.1 të Kushtetutës;
- j. Pika 14 është në kundërshtim me nenin 2.2., që lidhet me nenin 20.1, të Kushtetutës.

Zgjidhja e kërkuar nga parashtruesit e kërkesës:

35. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shpallë se, me miratimin e Ligjit për Ratifikim dhe me ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare:

- A. Qeveria ka shkelur rregullat procedurale që përmban neni 11 [Rezervat dhe deklaratat], që lidhet me nenin 5 [Procedura e shqyrtimit të projekt marrëveshjeve ndërkombëtare], të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052;
- B. Qeveria dhe Kuvendi kanë shkelur rregullat procedurale që përmban Kreu XIII [Procedura ligjvënëse] i Rregullores së punës të Kuvendit:
 - (1) Neni 54 [Kushtet e parashtrimit të një projektligji], paragrafi 1;
 - (2) Neni 57 [Shqyrtimi i projektligjit në komisione], paragrafi 1; dhe
 - (3) Neni 60 [Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare] paragrafi 2; si dhe

Shtojca Nr. 2 [Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e komisioneve parlamentare] e Rregullores së punës të Kuvendit:

- (1) pika 3 [Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi];
- (2) pika 5 [Komisioni për Punë të Jashtme] i Rregullores së punës të Kuvendit; dhe

C. Ligji i kontestuar dhe Aneksi 1 i këtij Ligji shkelin këto nene të Kushtetutës:

Kapitulli I [Dispozitat Themelore]:

- (1) Neni 1 [Përkufizimi i Shtetit], paragrafi 1;
- (2) Neni 2 [Sovraniteti], paragrafi 2;
- (3) Neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1;
- (4) Neni 20 [Bartja e Sovranitetit], paragrafi 1;

Kapitulli VII [Sistemi i Drejtësisë]:

- (1) Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafi 2;

Kapitulli X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial]:

- (1) Neni 123 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 3;
- (2) Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale];

Kapitulli XI [Sektori i Sigurisë]:

(1) Neni 125 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 2;

Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura]:

(1) Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], paragrafi 1.

36. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata të vendosë se Ligji i kontestuar është i pavlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.

39. Përkitazi me këto kritere, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, që parasheh si në vijim:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”. [Versioni në serbisht dallon nga versionet anglisht dhe shqip]

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, kur një ligj ose një akt i Kuvendit është në shqyrtim sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, procedura e vlerësimit do të jetë e natyrës pezulluese, që do të thotë se do të bllokohet shpallja e ligjit derisa Gjykata të marrë një vendim përfundimtar për rastin. Në pajtim me nenin 43 (2) të Ligjit, në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, *“ligji [...] i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*, që do të thotë se Ligji i miratuar nuk duhet t'i kthehet Kuvendit por duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet të cilat Gjykata i ka shpallur në Aktgjykimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën.

41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është ngritur nga 12 deputetë të Kuvendit të Kosovës, që është më shumë se minimumi i kërkuar me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, është plotësuar kriteri për palë të autorizuar.

42. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 42 të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës dhe thotë si vijon:

“Neni 42 Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.

43. Përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që kanë parashtruar kërkesën, është cekur edhe ligji i kontestuar dhe dispozitat relevante të Kushtetutës, si dhe provat që mbështesin kërkesën.
44. Sa i përket ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Ligjin, Nr. 04/L-199, për ratifikimin.
45. Rrjedhimisht, kërkesat nga neni 42 i Ligjit janë plotësuar.
46. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Ligji, Nr. 04/L-199, për Ratifikim është miratuar nga Kuvendi më 27 qershor 2013 (Vendimi Nr. 04-V-638), ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 4 korrik 2013. Kësisoj, kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë kushtetues prej tetë (8) ditësh.
47. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk ka bazë për shpalljen e kërkesës që ngrit çështje të rëndësishme kushtetuese si të papranueshme.

Analizë krahasimtare

48. Para hyrjes në analizë të asaj se a është ligji i kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën apo jo, Gjykata do të bëjë një analizë krahasimtare përkitazi me marrëdhënien ndërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rendit juridik vendës të shtetit. Në përgjithësi, në të gjitha shtetet kushtetuese, një marrëveshje ndërkombëtare së pari nënshkruhet nga një përfaqësues i lartë i shtetit. Nënshkrimi tregon vetëm ‘qëllimin për të marrë obligime nga marrëveshja’. Në mënyrë që të hyjnë në fuqi të drejtat dhe obligimet që përmban marrëveshja dhe të cilat bëhen të obligueshme për shtetin, marrëveshja duhet që, sipas Kushtetutës, të ratifikohet nga organi më i lartë legjislativ i shtetit, që është Parlamenti, Kongresi apo Kuvendi, si bartës i ‘sovrانيتit shtetëror’.
49. Kushtetutat e ndryshme të vendeve evropiane i qasen në mënyra të ndryshme çështjes së vlerësimit të kushtetutshmërisë së ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Këto dallime janë rezultat i mënyrave të ndryshme me të cilat definohen marrëdhëniet ndërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe rendit juridik vendës. Ky definicion mund të kuptohet se shtrihet përgjatë një spektri të qasjeve kushtetuese.

50. Në njërën anë qëndron qasja që ka përqafuar Britania e Madhe, ku marrëveshjet ndërkombëtare lidhen nga Mbretëresha përmes Ministrit të saj për Punët e Jashtme dhe Komonveltit (Commonwealth) dhe nuk është e domosdoshme që të ratifikohen nga Parlamenti Britanik, para se të bëhen të obligueshme për shtetin. Posa të lidhen ato e detyrojnë shtetin vetëm sa i përket marrëdhënieve me shtetet e tjera, dhe nuk kanë fuqi në rendin e brendshëm juridik të Mbretërisë së Bashkuar. Në mënyrë që dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare të hyjnë në fuqi brenda rendit juridik vendës, duhet të miratohet legjislacioni i veçantë që përmban ato dispozita dhe që përcakton veprimin e tyre brenda rendit juridik vendës. Sapo të inkorporohen nëpërmjet legjislacionit të veçantë, këto dispozita qëndrojnë në një rend juridik më të ulët se Kushtetuta e shtetit.
51. Në anën e kundërt të spektrit, është qasja që ka përqafuar Holanda. Atje, pas ratifikimit nga Parlamenti, marrëveshja ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me vendet e tjera dhe çdo dispozitë e vetëzekutueshme e marrëveshjes bëhet e detyrueshme brenda rendit të brendshëm juridik. Për më tepër, dispozitat e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare janë të një rendi më të lartë juridik, madje, edhe se Kushtetuta e shtetit dhe legjislacioni vendës mund të shqyrtohet nga të gjitha gjykatat përkitazi me pajtueshmërinë e tij me obligimet që dalin nga marrëveshje të tilla ndërkombëtare.
52. Sistemi kushtetues i Kosovës bie në mes të këtyre dy shembujve. Pas ratifikimit nga ana e Kuvendit, një marrëveshje ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera dhe marrëveshjet e tilla bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Megjithatë, dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare, që janë të vetëzekutueshme, janë të një rendi më të lartë juridik se legjislacioni i Kosovës, porse qëndrojnë në një rend juridik më të ulët se Kushtetuta e Kosovës, siç përcaktohet me nenin 19 të Kushtetutës. Dispozitat e vetëzekutueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të zbatohen drejtpërdrejt brenda rendit të brendshëm juridik të Kosovës, por zbatimi i tyre i nënshtrohet Kushtetutës.

Shqipëria

53. Sa i përket Shqipërisë, Gjykata vëren se Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 91, pika ë, ndër kompetencat e tjera, autorizon Presidentin të lidhë marrëveshje ndërkombëtare në pajtim me ligjin. Për më tepër, neni 121 i Kushtetutës specifikon llojet e marrëveshjeve që duhet të ratifikohen nga Kuvendi. Pas ratifikimit nga Kuvendi dhe pas botimit të marrëveshjes ndërkombëtare në Fletoren Zyrtare, marrëveshja e ratifikuar ndërkombëtare bëhet pjesë e rendit të brendshëm juridik në pajtim me nenin 122 të Kushtetutës.
54. Sa i përket rolit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë përkitazi me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, neni 131 i Kushtetutës parasheh që Gjykata Kushtetuese vendos, *inter alia*, për “pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre”.
55. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet Vendimit Nr. 15, të 15 prillit 2010, të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, ku ajo vlerësoi pajtueshmërinë me

Kushtetutën të Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe të zonave të tjera detare që u takojnë vendeve përkatëse në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e deklaroi Marrëveshjen si të papajtueshme me nenet: 3, 4, 7 dhe 92 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Bosnja dhe Hercegovina

56. Sa i përket Bosnjës dhe Hercegovinës, Gjykata vëren se Kushtetuta e saj, në nenin IV, rregullon kompetencat e Asamblesë Parlamentare dhe thotë, si në vijim: *“Asambleja Parlamentare ka kompetencë për: [...] (d) të vendosur nëse do të japë miratimin për ratifikimin e marrëveshjeve”*.
57. Neni V i Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës parasheh: *“Kryesia ka kompetencë për: [...] (d) negocimin, shpalljen e pavlefshme dhe, me miratimin e Asamblesë Parlamentare, ratifikimin e marrëveshjeve të Bosnjës dhe Hercegovinës”*.
58. Sa i përket kompetencave të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk i jep juridiksion asaj Gjykate përkitazi me vlerësimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Bullgaria

59. Sa i përket Bullgarisë, Gjykata vëren se Kushtetuta e saj i jep kompetenca, si Presidentit ashtu edhe Qeverisë, për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare në rrethana të përcaktuara me ligj. Neni 98 i Kushtetutës thotë, si në vijim: *“Presidenti i Republikës: [...] 3. lidh marrëveshje ndërkombëtare në rrethana të përcaktuara me ligj”*. Neni 106 i Kushtetutës thotë, si në vijim: *“Këshilli i Ministrave [...] lidh, konfirmon apo shpall të pavlefshme marrëveshje ndërkombëtare kur autorizohet me ligj për ta bërë këtë”*.
60. Sa i përket Kuvendit, Gjykata vëren se kompetencat e tij janë të përcaktuara me nenin 85 të Kushtetutës së Bullgarisë, ku thuhet, si në vijim: *“Kuvendi Kombëtar ratifikon ose shpall të pavlefshme me ligj të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që: 1. janë të natyrës politike apo ushtarake; 2. kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e Republikës së Bullgarisë në organizata ndërkombëtare; 3. parashohin korigjim të kufijve të Republikës së Bullgarisë; 4. përmbajnë obligime për thesarin; 5. parashohin pjesëmarrjen e Shtetit në arbitrimin ndërkombëtar ose në procedura ligjore; 6. kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut; 7. ndikojnë në veprimin e ligjit apo kërkojnë legjislacion të ri për t’u zbatuar; 8. shprehimisht kërkojnë ratifikim”*.
61. Roli i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë është përcaktuar me nenin 149.4 të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese: [...] 4. vendos për pajtueshmërinë ndërmjet Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga ana e Republikës së Bullgarisë para ratifikimit të tyre, dhe për pajtueshmërinë e ligjeve vendëse me normat e pranuar universale të së drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bullgaria është palë; [...]”*.

Kroacia

62. Kushtetuta e Kroacisë, përkitazi me inkorporimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik vendës, parasheh, si në vijim:

[...]

Kapitulli VII [Marrëdhëniet Ndërkombëtare]

Pjesa 1 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]

Neni 138 [Kompetenca e Përbashkët]

Marrëveshjet ndërkombëtare lidhen, në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare, varësisht nga natyra dhe përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare, brenda autoritetit të Parlamentit kroat, Presidentit të Republikës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Neni 139 [Ratifikimi, Ratifikimi i kualifikuar]

- (1) Marrëveshjet ndërkombëtare që kërkojnë miratimin e ndryshimit të ligjeve, marrëveshjet ndërkombëtare të natyrës ushtarake dhe politike, dhe marrëveshjet ndërkombëtare që paraqesin obligim financiar për Republikën e Kroacisë, i nënshtrohen ratifikimit nga Parlamenti kroat.*
- (2) Marrëveshjet ndërkombëtare që u japin organizatave dhe aleancave ndërkombëtare kompetenca që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, ratifikohen nga Parlamenti kroat me votën e dy të tretave të të gjithë përfaqësuesve.*
- (3) Presidenti i Republikës nënshkruan dokumentet e ratifikimit, lejimin, miratimin apo pranimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti kroat, në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.*
- (4) Marrëveshjet ndërkombëtare që nuk i nënshtrohen ratifikimit nga Parlamenti kroat lidhen nga Presidenti i Republikës me propozim të Qeverisë, ose nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.*

Neni 140 [Epërsia ndaj Ligjit]

Marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura dhe të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën dhe të publikuara, dhe që janë në fuqi, bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kroacisë dhe, në aspektin e efekteve juridike, janë mbi ligjin. Dispozitat e tyre mund të ndryshohen ose të shfuqizohen vetëm në kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me to apo në pajtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[...]"

63. Megjithatë, sa i përket rolit të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë përkitazi me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk i jep ndonjë kompetencë Gjykatës për ta vlerësuar marrëveshjet ndërkombëtare si të tilla. Kjo është riafirmuar me Vendimin U-I/1583/2000, ku Gjykata Kushtetuese e Kroacisë refuzoi kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së një ligji për ratifikim të miratuar nga organi ligjvënës. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë konstatoi se është kompetente për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, por jo edhe për vlerësimin e vetë marrëveshjes ndërkombëtare (pra, për përmbajtjen e saj) që është pjesë përbërëse e aktit të ratifikimit.

Maqedonia

64. Në Republikën e Maqedonisë, raporti ndërmjet të drejtës nacionale dhe të drejtës ndërkombëtare, rregullohet me dy nene të ndërlidhura të Kushtetutës. Sipas nenit 118 të Kushtetutës së Maqedonisë, marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Sipas nenit 68 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare i ratifikon Parlamenti.
65. Sa i përket Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, Gjykata vëren se neni 110 i Kushtetutës së Maqedonisë nuk e parasheh shprehimisht kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe as që ka ndonjë kompetencë për vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjeve që ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare. Pavarësisht nga kjo, në vitin 2002, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë shfuqizoi ligjin për ratifikimin e një marrëveshjeje bilaterale, pasi marrëveshja përmbante dispozita që e shkelnin Kushtetutën, por nuk i shfuqizoi dispozitat në fjalë të marrëveshjes duke gjetur se, po ta bënte një gjë të tillë, do të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë argumentoi se, pasi Kushtetuta inkorporon marrëveshjet ndërkombëtare në korpusin e rendit të brendshëm juridik në rang më të ulët se Kushtetuta, Gjykata e ndërton kompetencën e saj sipas teorisë që, duke qenë se një marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare bëhet pjesë e rendit të brendshëm juridik, e njëjta, sikurse çdo rregullore tjetër, duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe, rrjedhimisht, duhet të jetë e vlerësueshme nga Gjykata. Megjithatë, ky qëndrim ka ndryshuar dhe shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë kanë marrë qëndrim se kontrolli i kushtetutshmërisë në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare kryhet nga Parlamenti në procesin e ratifikimit të tyre, pas të cilit ato bëhen pjesë e rendit juridik të vendit dhe janë të vetekzekutueshme. Pra, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë nuk do të vlerësojë marrëveshjet ndërkombëtare.

Slllovenia

66. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, në nenin 8, parasheh: *“Ligjet dhe rregulloret duhet të jenë në pajtim me parimet e pranuar universale të së drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshjet që janë të detyrueshme për Slloveninë. Marrëveshjet e ratifikuara dhe të publikuara zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë”*.
67. Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të nenit 153, *“Ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën. Ligjet duhet të jenë në përputhje me parimet e pranuar universale të së drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshjet e vlefshme të ratifikuara nga Kuvendi Kombëtar, ndërsa rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike duhet po ashtu të jenë në pajtim me marrëveshjet e tjera të ratifikuara”*.
68. Sa i përket Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, Gjykata vëren se neni 160 [Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese] përmban dispozita relevante përkitazi me marrëveshjet ndërkombëtare. Konkretisht, paragrafi 1 përcakton që Gjykata Kushtetuese, *inter alia*, vendos *“[...] për pajtueshmërinë e ligjeve dhe të rregulloreve të tjera me marrëveshjet e ratifikuara dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare [...]”*. Përveç kësaj, paragrafi 2 i nenit të njëjtë thotë: *“Në procesin e ratifikimit të marrëveshjes, Gjykata Kushtetuese, me propozim të Presidentit të Republikës, të Qeverisë ose të një të tretës së deputetëve të Kuvendit Kombëtar, nxjerr mendim përkitazi me pajtueshmërinë e një marrëveshje të tillë me Kushtetutën. Mendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues për Kuvendin Kombëtar”*.
69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Vendimit U-I-128/98 të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, ku ajo kishte konstatuar: *“[...] Gjykata Kushtetuese është gjithmonë e autorizuar për të bërë vlerësimin e një ligji edhe nëse i njëjti, për nga përmbajtja, është akt juridik individual. Me inkorporimin e dispozitave të një marrëveshjeje ndërkombëtare në aktin e ratifikimit, të njëjtave nuk u njihet karakteri juridik i dispozitave ligjore. Në mënyrë të ngjashme, vetëm për shkak se akti i ratifikimit inkorporon një marrëveshje ndërkombëtare, dispozitave të këtij akti nuk i njihet karakteri juridik i një marrëveshjeje ndërkombëtare. Kësisoj, akti për ratifikimin dhe marrëveshja ndërkombëtare, miratimi i së cilës konfirmohet nga i pari, nuk janë akt i njëjti juridik. Po ashtu, për nga karakteri i tyre juridik, këto dy akte juridike nuk janë identike. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit për ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, në pajtim me atë dispozitë të Kushtetutës që i jep Gjykatës juridiksion për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën [...]”*.

Meritat

70. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje, Nr. 04/L-199, është në kundërshtim me Kushtetutën, si për nga procedura e ndjekur ashtu edhe për nga përmbajtja.

Sa i përket procedurës së ndjekur për miratimin e ligjit të kontestuar

71. Parashtruesit e kërkesës ankohen se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar është në kundërshtim me:
- nenin 11, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, pasi “[...] Projektligjit nuk i është bashkëngjitur asnjë deklaratë apo rezervë”;
 - nenin 54, paragrafi 1, dhe nenin 60, paragrafi 1, të Rregullores së punës të Kuvendit, pasi “[...] mungon deklaratata financiare”;
 - nenin 57, paragrafi 1, dhe pikën 2 të Shtojcës 2 të Rregullores së punës të Kuvendit, pasi “[...] Komisioni për Legjislacion dhe ai për Buxhet dhe Financa nuk e kanë shqyrtuar dhe nuk kanë dhënë mendim për atë se a është Marrëveshja në përputhje me Kushtetutën apo jo”;
 - pikën 5, të Shtojcës 2, të Rregullores së punës të Kuvendit, pasi “[...] Komisioni për Punë të Jashtme nuk e ka shqyrtuar atë”.
72. Megjithatë, Gjykata thekson se ajo vetëm mund të analizojë hapat e ndërmarrë nga Qeveria dhe nga Kuvendi për miratimin e ligjit të kontestuar mbi bazën e dispozitave relevante kushtetuese.
73. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kompetencat e Kuvendit janë të përcaktuara me nenin 65 të Kushtetutës, prej të cilave, për rastin konkret, relevantë janë vetëm paragrafi 1 dhe paragrafi 4, ku thuhet:
- “Kuvendi i Republikës së Kosovës:*
(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
[...]
(4) ratifikon traktatet ndërkombëtare”.
74. Në rastin konkret, Kuvendi, në mbështetje të kompetencës së tij nga neni 65.1 i Kushtetutës, votoi dhe miratoi Ligjin për Ratifikim, në pajtim me kërkesat për miratimin e një ligji, të parapara me nenin 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, që parasheh: *“Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë”.*
75. Për më tepër, Gjykata po ashtu i referohet nenit 18.1 të Kushtetutës dhe nenit 10.2 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, që përcakton procedurën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] thotë, si në vijim:
- “Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:*
(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës”.

76. Si i tillë, ratifikimi i ‘Marrëveshjes së parë ndërkombëtare’ është brenda fushëveprimit të nenit 18.1 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, kërkon votën e dy të tretave në Kuvend për miratimin e Ligjit për Ratifikim.
77. Sa i përket çështjes se cili autoritet i shtetit ka kompetencë për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, Gjykata i referohet nenit 2 (c) të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, të vitit 1969, e cila definojnë termin “fuqitë e plota” si: “[...] një dokument që rrjedh nga një autoritet kompetent i një shteti dhe që emëron një ose disa persona të cilët përfaqësojnë shtetin në zhvillimin e bisedimeve, në miratimin ose në sigurimin e tekstit të një traktati, për të shprehur pëlqimin e një shteti për të qenë i lidhur nga një traktat, ose për të përfunduar çdo akt tjetër që lidhet me një traktat”.
78. Sa i përket kësaj, Gjykata vëren se referenca për “autoritetin kompetent” për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, ia lë të drejtës së brendshme të secilit shtet të përcaktojë autoritetin që jep fuqitë e plota. Zakonisht, dokumente të tilla burojnë nga shefi i shtetit (ose nga dikush të cilit ai/ajo i ka deleguar kompetencat e nevojshme), shefi i Qeverisë ose ministri i Jashtëm dhe mban emblemën zyrtare dhe, në disa raste, edhe vulën e shtetit.
79. Përveç kësaj, e drejta e brendshme e Kosovës, që rregullon se cilat institucione janë të autorizuara për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, është e specifikuar në nenin 6 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, që thotë:

[...]

1. *Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.*

2. *Shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës, ose përfaqësuesi i autorizuar i Republikës së Kosovës në një konferencë ndërkombëtare, organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre, ka të drejtën e negociimit të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, ose të miratojë tekstin me shtetin në të cilin është akredituar ose në konferencën ndërkombëtare, organizatën ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre.*

3. *Personat e tjerë mund të kryejnë veprime drejt lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës vetëm me kusht që kanë fuqi të deleguara në bazë të ligjit në fuqi dhe procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.*

[...]

80. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, më 18 tetor 2012, Kuvendi e autorizoi Qeverinë që të udhëheqë procesin e arritjes së marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për të normalizuar marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy shteteve (Shih paragrafin 14). Përveç kësaj,

Gjykata vëren se Kuvendi më pas nxori vendime të tjera me të cilat deklaroi përkrahjen për Qeverinë për të vazhduar këto negociata (Shih paragrafin 15).

81. Pas kësaj, Qeveria, në bazë të autorizimit të dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, lidhi Marrëveshjen e parë ndërkombëtare me Republikën e Serbisë, më 19 prill 2013.
82. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet nenit 10 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, që parasheh:

[...]

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

- 1.1. territori, paqja, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;*
- 1.2. të drejtat dhe liritë fundamentale;*
- 1.3. anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;*
- 1.4. marrja e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.*

2. Marrëveshjet ndërkombëtare, të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, ratifikohen me ligj të votuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

[...]

83. Sa i përket kërkesës së përcaktuar me nenin 10.2 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, Gjykata vëren se, me qëllim të inkorporimit të marrëveshjes në rendin juridik të Kosovës, Qeveria është përgjegjëse për t'ia dorëzuar Kuvendit, në bazë të procedurës së paraparë, një projekt të ligjit adekuat, në pajtim me nenin 15.3 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, ku thuhet: *“Nëse një ligj ose ndonjë akt tjetër ligjor miratohet me qëllim të zbatimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, Qeveria dorëzon në Kuvend, në bazë të procedurës së paraparë, një projekt të ligjit adekuat ose duhet të miratojë një vendim të Qeverisë, ose siguron miratimin e ndonjë akti tjetër ligjor në bazë të kompetencave përkatëse”.*
84. Për më tepër, Gjykata vëren se, më 28 maj 2013, Qeveria, në mbështetje të kompetencave të saj nga neni 92.4 i Kushtetutës dhe në bazë të Rezolutës nr. 04-R-08 (Shih paragrafin 14), i propozoi Kuvendit për miratim Projektligjin për Ratifikim.
85. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 60 të Rregullores së punës të Kuvendit që rregullon miratimin e ligjeve të këtij lloji, e që dallon nga ligjet e tjera, dhe që përcakton si në vijim:

[...]

1. *Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare me ligj, në bazë të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.*
2. *Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare i përmban tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit dhe deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore.*
3. *Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.*

[...]

86. Përkitazi me këtë, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet formulimit të nenit 60, paragrafi 3, ku thuhet: *“Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi”*. Ligjet e tjera, të miratuara nga Kuvendi, kërkojnë më shumë se një lexim.
87. Duke marrë parasysh vlerësimet e lartpërmendura, Gjykata vëren se Kuvendi e ka respektuar procedurën e përcaktuar me nenin 65.1, me nenin 65.4 dhe me nenin 18.1 të Kushtetutës; me nenin 10 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare; dhe me rregullin 60 të Rregullores së punës të Kuvendit.
88. Gjykata rrjedhimisht konkludon se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar është zhvilluar në pajtim me dispozitat e parapara me Kushtetutë.
89. Për më tepër, sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës se *“[...] mungon deklarata financiare”*, Gjykata vëren se neni 60, paragrafi 2, i Rregullores së punës të Kuvendit qartazi specifikon se deklarata financiare bashkëngjitet vetëm *në rastet* kur ka implikime financiare, që është në diskrecionin e Qeverisë për të vlerësuar se a do të ketë implikime financiare apo jo.
90. Për më tepër, neni 60 i Rregullores së punës, që aplikohet në rastin konkret, vetëm parasheh që Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare përmban:
 - a. tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare,
 - b. arsyet e ratifikimit, dhe
 - c. deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore.
91. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kjo ankesë ka të bëjë me një çështje të ligjshmërisë dhe, si e tillë, bie jashtë juridiksionit të Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të merret me të, ashtu siç është vendosur më herët nga ana e Gjykatës në Rastin KO29/11, që *“[...] detyrë e saj është të shqyrtojë vetëm shkeljet e supozuara të Kushtetutës”* (Shih, Rasti Nr. KO29/11, Parashtrues i kërkesës Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Aktgjykim i 30 marsit 2011).

92. Sa i përket pjesës së kërkesës përkitazi me ankesën procedurale për miratimin e Ligjit për Ratifikim, Gjykata konkludon se procedura e ndjekur për miratimin e këtij ligji është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sa i përket përmbajtjes së ligjit të kontestuar

93. Parashtruesit e kërkesës paraqesin një numër të ankesave specifike përkitazi me pikat e ndryshme që përmban Marrëveshja e parë ndërkombëtare.
94. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se marrëveshjet ndërkombëtare shërbejnë për plotësimin e një nevoje themelore të shteteve për të rregulluar, me pëlqim, çështjet e shqetësimit të përbashkët, dhe kësaj të sjellin stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet, besueshmëri dhe rend në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, marrëveshjet gjithmonë kanë qenë burim kryesor i marrëdhënieve juridike ndërmjet shteteve.
95. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, së pari, duhet të shqyrtojë nëse është kompetente në bazë të Kushtetutës për të trajtuar këto ankesa. Siç u përmend më lart në analizën krahasimtare, janë disa kushtetuta që i japin kompetenca Gjykatës Kushtetuese për të bërë vlerësimin e pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën. Për shembull, Shqipëria dhe Bullgaria u japin gjykatave të tyre kushtetuese kompetencë për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një marrëveshjeje ndërkombëtare para ratifikimit të saj, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia janë përcaktuar të mos u japin gjykatave të tyre kushtetuese juridiksion për të vlerësuar marrëveshjet ndërkombëtare. Përveç këtyre, Sllovenia ka përqafuar një sistem të përzier ku, gjatë procedurës së ratifikimit, Gjykata Kushtetuese vlerëson kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare nëse shprehimisht kërkohet të veprohet ashtu nga Presidenti, nga Qeveria, apo nga një e treta e deputetëve të Parlamentit.
96. Kësaj, analiza krahasimtare zbulon se gjykatat kushtetuese të vendeve të hulumtuara nuk kanë juridiksion për të vlerësuar kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas miratimit të ligjit për ratifikim nga Parlamenti. Megjithatë, disa gjykata kushtetuese, në të vërtetë, mund të vlerësojnë kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre.
97. Gjykata konsideron se miratimi nga Kuvendi i Ligjit për Ratifikim dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së parë ndërkombëtare nga Qeveria, janë dy akte të ndara juridike. Për secilin prej këtyre akteve juridike zhvillohen procedura të ndryshme ligjore, për miratimin e Ligjit për Ratifikim në rastin e parë të përmendur, respektivisht për nënshkrimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare në rastin e dytë të përmendur. Sa i përket miratimit të Ligjit për Ratifikim nga Kuvendi, Gjykata vëren se Ligji për Ratifikim është miratuar me shumicën e dy të tretave në një lexim, ashtu siç kërkohet. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se miratimi nga Kuvendi i Ligjit për Ratifikim është bërë në përputhje me dispozitat procedurale të Kushtetutës.

98. Gjithashtu, Gjykata është e mendimit se qëllimi i ligjit të kontestuar është të përcaktojë karakterin detyrues të Marrëveshjes për shtetin e Kosovës dhe të inkorporojë Marrëveshjen e parë ndërkombëtare në sistemin juridik të Kosovës.
99. Sa i përket përmbajtjes së Marrëveshjes së parë ndërkombëtare, Gjykata vëren se asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së marrëveshjeve ndërkombëtare nga Gjykata Kushtetuese.
100. Në këto rrethana rezulton që, në bazë të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion për të vlerësuar Ligjin për Ratifikim, por nuk është e autorizuar për të vlerësuar se a është marrëveshja ndërkombëtare, si e tillë, në përputhje me Kushtetutën.
101. Gjykata konkludon se nuk është brenda juridiksionit të saj *ratione materiae* të vlerësojë kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Gjykata refuzon kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Marrëveshjes së parë ndërkombëtare.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, rrjedhimisht, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 20 të Ligjit; dhe në mbështetje të rregullit 36 të Rregullores së punës, më 2 shtator 2013,

VENDOSI

- I. NJËZËRI, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. NJËZËRI, TË SHPALLË që procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- III. ME SHUMICË VOTASH, TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesve për vlerësimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje, pasi kjo bie jashtë fushëveprimit të juridiksionit *ratione materiae* të Gjykatës;
- IV. TË SHPALLË që, në pajtim me nenin 43 të Ligjit, ky ligj i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;
- V. T'UA KOMUNIKOJË këtë aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- VI. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VII. TË SHPALLË që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani